



## KOMUNA VUSHTRRI

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRN  
02 Nr. / Br 1467/23  
Nr. i fq. / Br. st \_\_\_\_\_  
Data: / Datum 08.12.2023  
VUSHTRRI - VUČITRN



Bazuar në nenin 5, 14 dhe 17 shkronja "F" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28, 04 Qershor 2008), nenin 13 paragrafi 1.6 dhe 44 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, si dhe duke pasqer parasyshë interesin e përbashkët për zgjerim dhe përmirësim të infrastrukturës së ujësjellësit në komunën e Vushtrrisë, palët:

- K.R.U Mitrovica përfaqësuar nga z. **Bashkim Kurti**, Kryeshef Ekzekutiv (këtu e tutje, KRUM), dhe
- Komuna e Vushtrrisë përfaqësuar nga z. **Ferit Idrizi**, Kryetar i Komunës (këtu e tutje, Komuna) me datën 08.12.2023 lidhin këtë:

### MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR BASHKËFINANCIM TË PROJEKTIT

**"Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Pantinë dhe Lagjen Mazhiqi në Vushtrri"**

#### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është bashkëfinancimi i projektit **"Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Pantinë dhe Lagjen Mazhiqi në Vushtrri"** - matje e saktë, shërbim cilësor dhe kualitativ për banoret e zonës, duke vendosur ujëmatës zonal dhe reduktues presioni me të cilët menaxhohet presioni i ujit në rrjet.

#### Neni 2 Vlera e projektit dhe financimi

- 2.1 Vlera e përgjithshme e projektit **"Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Pantinë dhe Lagjen Mazhiqi në Vushtrri"** është 42,000.00 € € (katërdhjetë e dymijë euro).
- 2.2 KRU Mitrovica financon këtë projekt me 40 % të vlerës së përgjithshme të projektit ose 16,800.00 € (gjashtëmbëdhjetëmijë e tetëqind euro),
- 2.3 Komuna e Vushtrrisë financon nga buxheti i saj në këtë projekt me 60 % ose 25,200.00 € (njëzetepesëmijë e dyqind euro). Këto mjete do të i transferohen KRU Mitrovica në vitin 2024, bazuar në situacionet për punët e kryera që do të raportohen nga menaxheri/mbikëqyrësi i projektit.



2.4 Çdo obligim shtesë financiar që mund të dal mbi shumën e shënuar në pikën 2.1 të këtij neni, do t'i bartë KRU Mitrovica.

2.5 Mjetet financiare eventualisht të mbetura pas përfundimit të projektit nga kjo marrëveshje i kthehen bashkëfinancuesve sipas përqindjes së pjesëmarrjes me mjete në këtë projekt.

### **Neni 3 Realizimi i projektit**

Projekti ” **Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Pantinë dhe Lagjen Mazhiqi në Vushtrri**” do të realizohet brenda vitit 2024, në bazë të projektit që do t'a siguroj KRU Mitrovica i cili është pjesë e kësaj marrëveshje i bashkëngjitur në shtojcë.

### **Neni 4 Obligimet e KRUM**

4.1 KRUM siguron mjetet nga neni 2 pika 2.2 i kësaj Marrëveshje dhe një kopje të dokumentit mbi sigurimin e mjeteve e dërgon në Komunë.

4.2 KRUM do të udhëheqë procedurat e tenderimit për implementim të projektit të kësaj marrëveshje.

4.3 Menaxheri/organi mbikëqyrës i KRU Mitrovica në bashkëpunim me përfaqësuesin kompetent të komunës me përgjegjësi të plotë vërtetojnë sasinë dhe kualitetin e punëve/furnizimeve të kryera në bazë të cilave lëshohet dokumenti financiar me kërkesë për kryerje të pagesës nga komuna të punëve/furnizimeve në bazë specifikimeve për kryerje të punëve në projektin e kësaj marrëveshje.

4.4 KRUM, për të realizuar pagesat nga komuna për punët/furnizimet e kryera duhet të kompletoj këto dokumente:

4.4.1 Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës apo komisionit të pranimit për punët/furnizimet e kryera dhe të aprovuara (situationet e aprovuara).

4.4.2 Faturën origjinale nga KRUM deri në lartësinë e shumës së financuar nga Komuna.

4.5 KRUM duhet të ndërmerr të gjitha masat që mjetet e ndara nga KRUM për këtë projekt sipas nenin 2 pika 2.2 të kësaj marrëveshje të realizohen gjatë vitit 2024.

4.6 KRUM obligohet që ti dërgoj komunës së Vushtrrisë raport mujor në fillim të çdo muaji me të cilin raportohet rreth ecurisë së projektit dhe t'i paraqes progresin e marrëveshjes duke përfshirë këtu edhe progresin e pagesave deri në përfundim të projektit.

### **Neni 5 Obligimet e Komunës**

5.1 Komuna e Vushtrrisë i zoton mjetet për projektin nga neni 2 i kësaj marrëveshje dhe një kopje të dokumentit me të cilin dëshkohet se janë zotuar mjetet e dërgon në KRUM.

5.2 Pagesat nga Komuna për bashkëfinancim të projektit “**Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Pantinë dhe Lagjen Mazhiqi në Vushtrri**” do të bëhen sipas dinamikës së kryerjes së punëve dhe pas pranimit të raportit nga menaxheri/mbikëqyrësi i projektit për punët e përfunduara.

5.3 Pagesat do të kryhen nga buxheti i komunës - fondi për bashkëfinancim.

5.4 Komuna e Vushtrrisë cakton një zyrtar në cilësi të menaxherit/mbikëqyrësit i cili mbikëqyrë projektin nga fillimi deri në përfundim. Në rast se vëren parregullsi gjatë realizimit të projektit, e njofton Menaxhmentin e KRUM si dhe Menaxhmentin e Komunës .

#### **Neni 6 Pronësia e projektit**

Me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga KRUM dhe pranim të përkohshëm si dhe pas përfundimit të periudhës së defekteve eventuale, bëhet pranimi përfundimtar me ç 'rast ky investim nga kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit regjistrohet në pronësi të KRU Mitrovica.

#### **Neni 7 Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit**

8.1 Me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet me aneks marrëveshje.

8.2 Komuna mban të drejtën e ndërprerjes së shfrytëzimit të buxhetit për këtë destinim në rast se KRUM nuk i përmbushë obligimet e veta të dala nga kjo marrëveshje.

#### **Neni 8 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve eventuale**

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën çështja do të kalohet në Gjykatën kompetente.

#### **Nr. 9 Numri i ekzemplarëve**

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre (3) ekzemplar identik në origjinal, prej të cilëve dy (2) për komunën dhe një (1) për KRUM. Marrëveshja përmban 10 nene në katër (4) faqe A/4.

#### **Neni 10 Hyrja në fuqi**

Kjo marrëveshje të hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

